

Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)
Sesioni 3 & 4, Tema: “Ndhma Ligjore Falas dhe Informimi Ligjor i Publikut”.
17 maj 2016

Rekomandimet

Paneli 1: Ndhma Ligjore Falas

- **Disa nga detyrimet e shtetit shqiptar për të realizuar ofrimin e një shërbimi ligjor falas përfshijnë:**
 - Shërbimi ligjor falas duhet të ofrohet **jo vetën për personat me pamundësi ekonomike**, por edhe për grupe të tjera vulnerabël dhe pa mbështetje si viktimat e dhunës, fëmijë, azilantë etj.
 - Avokatitë e zhvilluara dhe të kualifikuara duhet të ofrojnë edhe shërbime **me tarifa të ulëta** dhe kosto të përbalueshme
 - Të zhvillohen **forma të tjera të zgjidhjes** së çështjeve dhe konflikteve si ndërmjetësimi apo mënyra të tjera me më pak kosto.
 - Gjykatat duhet të realizojnë një **vlerësim dhe ekspertizë objektive të çështjeve**.
 - Vetë sistemi gjyqësor duhet të gjenerojë dhe të **sigurojë të ardhura** duke mbuluar kështu kostot e rasteve kur shërbimi ligjor ofrohet falas. Në të njëjtën kohë shteti duhet të vazhdojë të financojë këtë sistem.

- **Bashkëpunimi i ngushtë me shoqërinë civile dhe sistemin gjyqësor:**
 - Problematikë është dhe fakti që shoqëria civile ofron **më shumë shërbime ligjore falas** se sa vetë shteti, duke nënkuptuar vështirësitë që ka shteti për ta siguruar këtë shërbim dhe nevoja për bashkëpunim më të ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat jo shtetërore.
 - Duke qenë që shoqëria civile mbështetet për realizimin e projekteve edhe nga financimet e bëra nga Bashkimi Europian fokusi mbi **Fushën e Monitorimit dhe Aksesin në Drejtësi**, duhet të jetë prioritare sa i përket realizimit të projekteve dhe financimit dhe mbështetjes që duhet të jepet në këtë drejtim.
 - **Koalicioni i Shoqërisë Civile për Drejtësinë** duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë kuadër, ku kërkohet më shumë bashkëpunim dhe sinergji mes palëve.

- **Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike** vlerëson si pozitive punën e tij, pasi në mbi 90% e rasteve të marra në shqyrtim janë të fituara. Ka një problematikë përsa i përket **përgjigjes së nevojave të personave për shkak të buxhetit të ulët dhe pamundësisë për financim**.
 - Buxheti vazhdon të **mbetet një problem për sa i përket realizimit të këtij shërbimi** dhe kjo vihet re edhe për faktin që është e pamundur që të bëhet e plotë dhe **në kohë pagesa e avokatëve** që ofrojnë shërbimin. Ndodh shpesh që TVSH-të e prapambetura të vitit të kaluar të mbarten në vitin e ardhshëm të buxhetit duke çuar në konsumim të tij.
 - Buxheti i komisionit është i barabartë me buxhetin vjetor të Gjykatës së Tiranës. Duhet të ketë një iniciativë nga Ministria e Financave për të ndryshuar madhësinë e buxhetit të KSHNJ ose në rrethe pushteti ka për detyrë të ofrojë kushte sepse zyrën e jep Avokati i Popullit atëherë buxheti mjafton.
 - Ligji për Ndhmën Juridike i amenduar në 2014 është i plotë dhe pa probleme madhore, **por zbatimi i tij mbetet i kufizuar** dhe i pamundur pasi mungon buxheti dhe mjetet e tjera të nevojshme për implementimin me sukses të ndihmës ligjore në Shqipëri.
-
- **Problematikat e shfaqura në punën dhe eficiencën e Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike:**
- 1) **Mungon Transparenca** pasi nuk ka paraqitje publike të informacioneve dhe procedurës së si ky Komision i përzgjedh çështjet që ofron ndihmën ligjore. Për më tepër nuk ka transparencë për sa i përket buxhetit dhe shpenzimeve të këtij institucioni. Hap pozitiv mbetet rritja e shpenzimeve për të paguar avokatët që nënkupton që është rritur numri i aplikantëve që u ofrohet shërbimi falas.
 - 2) Numri i çështjeve të pranuar nga Komisioni **është shumë i ulët** në krahasim me nevojat që ka popullsia shqiptare.
 - 3) Mungon **profesionalizmi dhe ekspertiza e avokatëve** të përzgjedhur nga KSHNJ. Ka shumë raste kur personat që kanë marrë ndihmën ligjore të kenë mbetur të pakënaqur
 - 4) Komisioni mbetet funksional **dhe aktiv vetëm në Tiranë** dhe 6 zyrat rajonale të ndihmës ligjore që janë hapur nuk janë ende plotësisht funksionale.
 - 5) Paaftësia e KSHNJ për të siguruar përjashtimin nga tarifat dhe kostot gjyqësore sidomos për çështjet civile dhe administrative.

Paneli II: Informimi dhe Edukimi Ligjor i Publikut

- E drejta për informim ligjor të publikut dhe aksesit në drejtësi është **një kusht themelor** për një shtet të së drejtës dhe respektim të lirive themelore të individit. Pa siguruar këtë të drejtë nuk mund të flitet për një shtet demokratik të së drejtës.
- Një pjesë e rëndësishme për informimin ligjor luan edhe **procesi i ndihmës paragjyqësore** që duhet të ofrohet falas, në mënyrë të tillë që individi të informohet
- Mungesa e një kulture të përgjithshme kulturore dhe pamundësitë sociale e bëjnë të vështirë që **qytetari të informohet edhe ligjërisht për të drejtat e tij** dhe shërbimet që i ofrohen për sa i përket çështjeve ligjore
- Fokus të veçantë për informimin ligjor duhet të ketë edhe **informimi i shqiptarëve që kanë kërkuar azil në vendet e Europës**, duke rritur ndërgjegjësimin dhe informimin e tyre mbi të drejtat që kanë si azilkërkues, raste kur kërkesa e tyre pranohet dhe çfarë mundësish i ofrohen nga shteti shqiptar kur ata kthehen në vendin e tyre. Kjo duhet të jetë në fokus të veçantë dhe të ketë specializim nga ana e autoriteteve të shtetit.
- Fletorja Zyrtare në Shqipëri është kontakti i parë i qytetarit me normat ligjore dhe aktet e tjera të nxjerra nga Shteti Shqiptar. Edhe pse një ndryshim pozitiv është përfshirja jo vetëm e ligjeve por e të gjitha normat juridike si dekrete, VKM, apo vendimet e Gjykatës Kushtetuese, **mungon një sistem kërkimi online i akteve të përditësuara**.
- Kështu që aksesit në normat juridike edhe pse realizohet, është i **vështirë që të merret informacioni** në kohë reale dhe në raste të tjera nuk gjendet informacion për ato akte të vjetra dhe të kaluara në kohë.
- Shqipëria karakterizohet nga një **'Ndotje Legjislative'**, ku përveç ligjeve të shumta të miratuara ka dhe shumë Konventa Ndërkombëtare të nënshkruara nga shteti shqiptar. Kjo e vështirëson edhe më shumë procesin për gjetjen e ligjeve online sidomos nëse ato janë të vjetra.
- Një tjetër problematikë është edhe **mungesa e informacionit si të gjenden dhe ku të gjenden VKM-të**. Publiku nuk arrin dot të dijë se ku të kërkojë online për të gjetur këtë informacion. Mungon transparenca dhe aksesit i plotë për njohjen e gjithë kuadrin ligjor në Shqipëri. Kufizime ka në gjetjen e informacioneve për VKM, udhëzimet e ministrave apo vendimet e gjykatave.
- Mosnjohja me ligjin shkakton **moszbatim të plotë të tij** duke bërë që vetë demokracia të mos funksionojë siç duhet dhe qytetari të gabojë edhe pa e ditur që po shkel ligjin.
- Shoqëria civile mund të luajë një rol kyç në **realizimin e fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere** mbi njohjen e ligjit, informimit dhe edukimit ligjor të publikut të gjerë.
- Një arsye përse individët nuk janë të interesuar për t'u informuar mbi ligjin apo të drejtat e tyre në aksesin në drejtësi është se u mungon **besimi të institucionet e drejtësisë**. Ky është dhe një faktor që i bën ata indiferentë në zbatimin e plotë të ligjit.

Pjesëmarrësit e Sesionit 3 & 4 të Grupit të Punës I: Institucione Shtetërore dhe Shoqëri Civile

Institucione Shtetërore

Ministria e Drejtësisë:

SH.T.Z. Ylli Manjani, Ministër i Drejtësisë

Znj. Ketrin Treska

Znj. Tetis Lubonja

Z. Tomor Kapllani

Z. Petrit Bakiu

Z. Bledar Kabashi

Z. Arbër Kaçi

Znj. Emilda Prifti

Znj. Elda Spasse

Znj. Brikena Shehu

Znj. Najada Shundi

Ministria e Integritit European:

Znj. Brunilda Tushaj

Znj. Anila Dollani

Qendra e Botimeve Zyrtare:

Znj. Ardita Alsula , Drejtore

Znj. Sara Mborja

Komisioni Shtetëror i Ndhmës Ligjore: Znj. Blegina Agolli, Kryetare

Shoqëri Civile

Komiteti Shqiptar i Helsinkit: Znj. Vjollca Meçaj

Eksperti Sllovak: Z. Vladimir Kordos

INFOCIP: Z. Gerti Shella, Drejtor

Save the Children: Z. Sokol Muça , znj. Anila Meço

European Legal: Znj. Saimira Tola

Terre des Hommes: Znj. Orinda Gjoni

Fondacioni Soros: Znj. Besa Ombashi

World Vision in Albania and Kosovo: Znj. Vilma Çobani

ADRA Albania/Slovakia: Znj. Jana Fintova, Znj. Blerina Balla